

Vendim nr. 61 datë 23.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 23.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (F) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: FISNIK PULA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 3157, datë 11.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 3182 (86-2018-3503), datë 14.09.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 26, datë 20.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shpërblim dëmi material në masën 7500 lekë në ditë, shpërblim moral në masën 5.000.000 lekë, interesa në masën 2% në muaj nga data 23.11.2011 deri në vendimin përfundimtar të formës së prerë.

Detyrimi i palës së paditur të më pajisë me lejen përkatëse.

Kthimi në vendin ku ishin të 90 m² panele sanduiç.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 18, 21, 37, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Fisnik Pula është pronar i një banese në qytetin e Tiranës. Në muajin tetor 2011 kjo ndërtesë është dëmtuar nga kushtet atmosferike duke u shembur pjesërisht. Në këto kushte, kërkuesi ka vendosur të rindërtojë pjesërisht banesën, duke e mbuluar me panele sanduiç. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik (INU) i Bashkisë Tiranë, me vendimin nr. 169, datë 28.11.2011, ka vendosur pezullimin e punimeve të kryera nga kërkuesi, për sa i përket ndërtimit të katit të dytë të banesës së tij, si dhe sekuestrimin e materialeve me të cilat ishte mbuluar çatia. Gjithashtu, me vendimin nr. 549, datë 23.11.2011, INU-ja e Bashkisë Tiranë e ka dënuar atë me gjobë për ndërtimin pa leje në masën 708.325 lekë, vendim i cili është parashkruar për shkak të mosvjeljes së gjobës brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

2. Megjithëse kërkuesi i është drejtuar disa herë Bashkisë Tiranë për të kërkuar leje për rikonstruksionin e banesës, këto kërkesa janë refuzuar me argumentin se këshilli bashkiak nuk kishte miratuar instrumentin vendor të planifikimit për Bashkinë Tiranë dhe pas datës 22.08.2014 dhënia e lejeve të ndërtimit ishte pezulluar me vendimin nr. 1, datë 22.08.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit, deri në konstituimin e organeve të njësive të qeverisjes vendore.

3. Pas këtyre veprimeve kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt: *“Diskriminim, përdorim arbitrar i pushtetit, fyerje dhe cenim të dinjitetit, tejkalim i kompetencave. Detyrimin e palës së paditur të më pajisë me lejen përkatëse të paraqitur disa herë në bazë të projektit dhe kërkesave të ligjit. Kthimin në vendin ku ishin (vendosjen sërish në çati) të 90 m² panele sanduiç. Shpërblim dëmi pasuror e jopasuror”*, me palë të paditur Bashkinë Tiranë dhe person të tretë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4. Me vendimin nr. 3157, datë 11.06.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë.”*. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

5. Me vendimin nr. 3182 (86-2018-3503), datë 14.09.2018, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3157, datë 11.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 31003-02756-00-2018, datë 19.11.2018.

6. Në datën 14.07.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjykimit të

çështjes në këtë gjykatë. Me vendimin nr. 26, datë 20.10.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës me argumentin se vonesa në shqyrtimin e çështjes konkrete ka ardhur për arsye objektive.

7. Me kërkesën e datës 04.01.2023, e plotësuar në datën 25.01.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar:

- 8.1. *E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar ende rekursin, megjithëse kërkuesi prej 12 vjetësh gjendet në një situatë, në të cilën janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.
- 8.2. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vendimet e tyre nuk shprehen në mënyrë të qartë dhe bindëse, si dhe nuk pasqyrojnë situatën reale të kërkuetit.
- 8.3. *E drejta e pronës*, e parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi atij i është dhunuar banesa nga ana e punonjësve të policisë bashkiake, duke zbuluar çatinë dhe marrë materialet që e mbulonin atë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuetit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton

mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

13. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 3157, datë 11.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 3182 (86-2018-3503), datë 14.09.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, me pretendimin se atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të respektimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së pronës. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ai ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i regjistruar me nr. 31003-02756-00-2018, datë 19.11.2018, për të cilin ende nuk ka një vendim marrje.

15. Lidhur me këto pretendime, duke qenë se çështja e tij është ende në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka akoma mjete juridike në dispozicion për mbrojtjen e interesave të tij gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë dhe vetëm pas përfundimit të procesit gjyqësor edhe në atë gjykatë, ai mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual. Për rrjedhojë, përderisa kërkuesi pretendimet e tij nuk i lidh me vendimin përfundimtar e

përmbyllës të çështjes së tij, nuk legjitimohet për kundërshtimin e vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

16. Ndërsa lidhur me pretendimin për konstatimin e shkeljes së të drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për faktin se Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar ende rekursin e tij, duke tejkaluar afatet e gjykimit të çështjes, Kolegji konstaton se dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) parashikojnë mjetet juridike për t'u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Ato përcaktojnë se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), me çfarë mjetesh mbrohesh nga cenimi: kërkesa për përshpejtim (*neni 399/4*), kërkesa për dëmshpërblim dhe çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (*nenet 399/4 dhe 399/6*), rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*), marrja e vendimit (*neni 399/8*) etj. Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete juridike me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

17. Në lidhje me mjetet e parashikuara nga *nenet 399/1* e vijues të *KPC*-së, Gjykata ka pranuar se, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në veçanti, për kërkesën për përshpejtimin e procedurave, Gjykata është shprehur se ky lloj mjeti është "efektiv" nëse arrin të përshpejtojë vendimmarrjen e gjykatës në fjalë (*shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi e ka shteruar edhe këtë mjet procedural dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 26, datë 20.10.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit të rekursit të tij, me argumentin se vonesa në shqyrtimin e çështjes konkrete ka ardhur për arsye objektive. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi nuk ka mjete të tjera në dispozicion, ndaj do të analizojë në vijim legjitimitimin *ratione materiae* të tij për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

19. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se thelbi i pretendimeve të kërkuetit në ankimin kushtetues individual është cenimi i së drejtës së pronës. Konkretisht, ai ka kryer disa punime në banesën e tij, pa lejen përkatëse të ndërtimit dhe INU-së së Bashkisë Tiranë fillimisht ka vendosur pezullimin e tyre dhe më tej e ka dënuar administrativisht me gjobë kërkuetin. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi, rezulton se edhe pse kërkueti ka

pretenduar se cenimi i së drejtës së pronës ka ardhur si rezultat i akteve administrative të INU-së së Bashkisë Tiranë, ai nuk i ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore këto akte. Përkundrazi, kërkuksi ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor me objekt diskriminimin dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë për ta pajisur atë me lejen përkatëse të ndërtimit duke thirrur si person të tretë në proces edhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

20. Në kuptim të sa më sipër, mjeti procedural i përdorur nga kërkuksi në procesin e kundërshtuar, ashtu sikurse është arsyetuar edhe nga dy gjykatat më të ulëta, nuk është i tillë që ka shqyrtuar dhe ka vendosur për të drejtën e pronës së pretenduar të cenuar. Në këtë drejtim, Kolegji evidenton se një proces gjyqësor i nënshtrohet garancive të nenit 42 të Kushtetutës, në rast se mosmarrëveshja objekt gjykimi e tij lidhet me një të drejtë kushtetuese ose të ligjshme, për mbrojtjen dhe/ose ushtrimin e së cilës kërkuksi ka vepruar, dhe se rezultati i procesit është drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën në fjalë. Thënë ndryshe, garancitë e nenit 42 të Kushtetutës do të gjenin zbatim nëse procesi gjyqësor do të mund të ndryshonte situatën konkrete, e cila është bërë objekt mosmarrëveshjeje në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

21. Për rrjedhojë, në kushtet kur kërkuksi nuk ka arritur të provojë se procesi gjyqësor i kundërshtuar ka pasur në objektin e tij, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, të drejtën substanciale të pronës së pretenduar të cenuar, Kolegji vlerëson se ai nuk justifikon interesin kushtetues ose të ligjshëm, i cili qëndronte në themel të atij procesi. Prandaj, kërkuksi nuk legjitimohet *ratione materiae* për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues për kërkesën e tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procesit.

22. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuksit, për shpërblimin e dëmit, detyrimin e palës së paditur për ta pajisur atë me lejen përkatëse dhe kthimin e materialeve me të cilat ishte mbuluar banesa e tij, Kolegji vëren se, për nga natyra, ato nuk hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se çështja nuk i plotëson kriteret për shqyrtimin e saj në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.